

Gjykata Komunale në Prishtinë

P Nr. 2397/09

14 prill 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykatësi nga EULEX Francesco Florit, me ndihmën e Proces-Mbajtëses Jacqueline Ryan në lëndën penale kundër të pandehurve:

Plamen Dimitrov, i lindur më 8 prill 1978 në Sofia, Bullgari, emri i babait Ivan, me vendbanim në Rrugën Mladost- 1, BL 36, ET2 Sofia, Bullgaria, me kombësi bullgar, në paraburgim që nga 18 shtatori 2009;

Martin Ivanov, i lindur më 8 janar 1984 në Sofia, Bullgari, emri i babait Kiril, me vendbanim në Rrugën Mladost, B36 V9, kati i dytë, Sofia, Bullgari, me kombësi bullgare, në paraburgim që nga 18 shtatori 2009;

I ngarkuar me aktakuzën e ngritur në Gjykatën Komunale të Prishtinës më 21 dhjetor 2009 dhe të ndryshuar verbalisht më 14 prill 2010 për kryerjen e veprës penale të

Tentim hyrje në sistemet kompjuterike në bashkë-kryerje, në pajtim me Nenin 264 (1) dhe Nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit publik më 19 shkurt 2010, 3 mars 2010, 31 mars 2010 dhe 14 prill 2010 në praninë e Prokurorit Publik Haki Gecaj, të akuzuarve Plamen Dimitrov dhe Martin Ivanov dhe avokatëve të tyre mbrojtës Osman Havolli dhe Vahid Halili, përfaqësuesit të palës së dëmtuar, Pro Credit Bankës, Tomë Gashi, Trupi Gjykses shpall publikisht më 14 prill 2010 si në vijim:

AKTGJYKIM

Të pandehurit **Plamen Dimitrov** dhe **Martin Ivanov**, me të dhënat personale si më lart,

Shpallen fajtorë për veprën penale **Tentim hyrje në sistemet kompjuterike në bashkë-kryerje**, në pajtim me Nenin 264 (1) dhe Nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës;

Për shkak se:

Më 18 shtator të vitit 2009, të pandehurit në bashkë-kryerje rreth orës 18:40 në Rrugën Bill Clinton në Prishtinë me qëllim të përfitimit të paligjshëm financiar kanë tentuar të



hyjnë në sistemin kompjuterik të Bankës Pro-Credit dhe Raiffeisen Bankës në Kosovë. Në veçanti, ata janë pajisur me mini kamera të modifikuara për të vendosur në bankomate për të zbuluar pin kodet e kartelave bankare në mënyrë që së bashku me të dhënat e kartelave bankare, ata do të mund të duplikojnë kartelat me qëllim të tërheqjes së paligjshme të të hollave nga llogaritë bankare të klientëve; derisa ishin në afërsi të bankomateve të Bankës Pro Credit dhe asaj të Raiffeisen Bankës, ata janë kapur nga policia dhe i akuzuari Martin Ivanov ishte në posedim të mini kamerës së modifikuar në mënyrë të veçant dhe pajisjet e tjera elektronike janë gjetur në dhomën e tyre të hotelit në Hotel Plaza në Prishtinë.

Për këtë arsye, në pajtim me Nenet 38, 65 dhe 264, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës

I pandehuri Plamen Dimitrov dënohet

Me burgim prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj

I pandehuri Martin Ivanov dënohet

Me burgim prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj;

Kohën që kaluan të akuzuarit në paraburgim nga 18 shtator 2009 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit do të llogaritet si pjesë e dënimit me burgim në pajtim me Nenin 73, KPK.

Në pajtim me nenin 54, paragrafi 2, pika 9, KPK, dy të akuzuarit do të dëbohen nga territori i Kosovës pasi që të vuajnë dënimin.


Arsyetimi

Historiku procedural

Prokuori Publik Komunal në Prishtinë ka ngritur aktakuzën PP. Nr. 3286-9/2009 më 21 dhjetor 2009 duke ngarkuar të akuzuarit me veprën penale **Tentim hyrje në sistemet kompjuterike në bashkë-kryerje**, në pajtim me Nenin 264 (1) dhe Nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Më 29 dhjetor 2009, të pandehurit kërkuan gjykatës nga EULEX të marrë sipër lëndën. Më 11 shkurt 2010, Kryetarja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it u caktoi lëndën Gjykatësve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Shqyrtimi kryesor kundër të pandehurve filloi më 19 shkurt 2010 dhe vazhdoi më 3 mars 2010, me ç'rast është dashur të shtyhet për shkak të mungesës së disa palëve të dëmtuara të cilët nuk u identifikuar dhe njoftuar plotësisht.



Shqyrtimi kryesor vazhdoi më 23 mars 2010. Pas verifikimit se të gjitha palët janë njoftuar në mënyrë të rregullt, përfaqësuesi ligjor i Pro Credit Bankës Z.Tomë Gashi dorëzoi Trupit Gjykses letër autorizimi nga banka. Pas leximit të aktakuzës, Trupi Gjykses dëgjoi palët e dëmtuara në vijim në cilësinë e dëshmitarëve: Haxhi Arifi, Skender Misimi, Naser Sahiti dhe Sevdije Canolli. Gjatë seancës së njëjtë, trupi Gjykses dëgjoi edhe dëshminë e zyrtarëve të Policisë së Kosovës Zijadin Isaku dhe Avdush Jashari. Gjatë seancës së njëjtë, Prokurori Publik i dorëzoi Trupit Gjykses raportin e policisë së datës 29 shtator 2009 të nënshkruar nga Zyrtari Avdush Jashari.

Shqyrtimi kryesor vazhdoi më 31 mars 2010. Për t'u pajisur me informata më të detalizuara të disa aspekteve të lëndës, Trupi Gjykses dëgjoi sërish dëshmitarët Zijadin Isaku dhe Avdush Jashari (lidhur me rezultatin e ekspertizës së kërkuar nga instituti forenzik jashtë vendit dhe lidhur me ekzaminimin teknik të programeve të instaluar në kompjuterin i cili është konfiskuar nga të akuzuarit). Gjatë seancës, kompjuteri dhe pajisjet e tjera kompjuterike, të cilat u konfiskuan më 18 shtator 2009, u treguan në sallë të gjykimit.

Gjatë seancës së njëjtë, Trupi Gjykses mori në pyetje të pandehurit Plamen Dimitrov dhe Martin Ivanov.

Shqyrtimi kryesor vazhdoi më 14 prill 2010 me fjalët përfundimtare të prokurorit, përfaqësuesit ligjor të Pro Credit Bankës dhe të avokatëve mbrojtës të të pandehurve, Z. Osman Havolli dhe Z. Vahid Halili. Trupi Gjykses dëgjoi edhe fjalët përfundimtare të të pandehurve Plamen Dimitrov dhe Martin Ivanov.

Gjatë fjalës së tij përfundimtare, Prokurori Publik Komunal ndryshoi aktakuzën duke ndryshuar kualifikimin ligjor në **Tentim hyrje në sistemet kompjuterike në bashkë-kryerje**, në pajtim me Nenin 264 (1) dhe Nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës

Në fund të seancës së njëjtë, Trupi Gjykses publikisht shpalli aktgjykimin.

Të gjeturat faktike

Trupi Gjykses dëgjoi dëshmitë e palëve të dëmtuara të shënuar më lart. Dëshmitë i ofruan Trupit Gjykses një pamje të përgjithshme të ngjarjeve, por nuk ofruan prova të drejtpërdrejta lidhur me të pandehurit ngase palët e dëmtuara ishin vetëm viktimat të veprës së kryer penale dhe nuk dispononin informata të dobishme për të përcaktuar përgjegjësinë penale të veprës penale nga ana e dy të pandehurve.

Trupi Gjykses dëgjoi edhe dëshminë e zyrtarëve të policisë Zijadin Isaku dhe Avdush Jashari.



Nga deklaratat e tyre doli se pas operacionit të policisë me emrin "BANKAT", të kryer për shkak të numrit të madh të ankesave të bëra nga tërheqjet e paligjshme të të hollave nga llogaritë bankare në banka të ndryshme në gjithë Kosovën, më 18 shtator 2009 rreth orës 18:40, policia pranoi informata lidhur me sjellje të dyshimta të dy individëve. Si rezultat, Policia e Kosovës arrestoi të pandehurit në Rrugën "Bill Clinton" në Prishtinë në afërsi të bankomatit të Pro Credit Bankës.

Sendet si në vijim janë gjetur në posedim të të pandehurve në një dhomë në Hotel Plaza: një laptop kompjuter SONY me numrins serik C2004E7P, dy mini kamera të modifikuara në mënyrë manuale, njëra prej tyre me numrin serik ESH08-BU38, Modem 3G USB, numri serik X020X-8BNBG1-1; USB kapaciteti 2G, numri serik 30996-001, kablo rezervë kompjuterike, kredit kartela të ndryshme, para të gatshme në shumën prej €3.055,00 dhe disa të holla të imëta në Levi.


Martin Ivanov është gjetur në posedim të një ndër dy mini kamerat e modifikuara në çastin e kapjes nga policia.

Programet si në vijim janë gjetur në laptop kompjuterin: Data Doctor's Data Wiper; Magnetic Stripe Card Reader/ Writer; PGP (Pretty Good Privacy) Encryption. 2 fotografi (që përshkruajnë tastierën e bankomatit) dhe video regjistrime janë gjetur në kompjuter dhe në memorien e një ndër mini kamerave.

Më tutje, Zyrtari Zijadin Isaku sqaroi se është hetues në Policinë e Kosovës, i angazhuar në hetimin e veprat penale kompjuterike. Ai është thirrur në ditën e arrestimit të të pandehurve për të ofruar shërbimet e tij. Ai i sqaroi Trupit Gjykues se sendet e konfiskuara nuk janë për përdorim të zakonshëm dhe se përdoren në veçanti për vepra penale që kanë të bëjnë me "klonimin" e kartelave bankare dhe tërheqjes së paligjshme të të hollave nga llogaritë bankare. Dëshmitari dëshmoi se njëra mini kamerë e modifikuar kishte ngjites letre (të dyanshëm) në të, gjë e cila sugjeron se është ndërtuar për t'u ngjitur bankomateve. Zyrtari i sqaroi Trupit Gjykues se këto mini kamera kanë bateritë e tyre dhe syrin xhirues dhe se janë ndërtuar në një mënyrë të atillë për të mos u parë pas vendosjes së tyre në bankomat. Më tutje, zyrtari dëshmoi se të gjitha të dhënat nga laptopi i të pandehurve janë vendosur në një hard disk të jashtëm, i cili është dërguar në një qendër të specializuar jashtë, por nuk është marrë ndonjë përgjigje.

Zyrtari Avdush Jashari dëshmoi se është anëtar Policisë së Kosovës që nga 1 korriku 2002, duke punuar si ekspert i TI-së dhe ekzaminues i pajisjeve elektronike. Ai dëshmoi se në laptopin i cili u është konfiskuar të pandehurve, ai gjeti dy programe kompjuterike, njëri me emrin Magnetic Stripe Card Reader/ Writer dhe tjetri me emrin PGP (Pretty Good Privacy).

U sqarua se Programi Magnetic Stripe Card Reader/ Writer përdoret për të riprodhurat kartela bankare (i ashtuquajtur 'klonim').




Programi PGP është softver që përdoret për enkriptimin e informatave. Të dhënat dhe dosjet në laptop janë mbrojtur nga fjalëkalimi. Policia e Kosovës nuk ka softverin për të pasur qasje në të apo për ta dekoduar atë dhe për të zbuluar fjalëkalimin. Në mungesë të fjalëkalimit, nuk mund të shihet përmbajtja e dosjeve. Dëshmtiarit i kujtohet se ishin dy (2) fotografi të tastierës së bankomatit dhe një regjistrim video që i është dhënë hetuesit.

I pandehuri Plamen Dimitrov me rastin e marrjes në pyetje dëshmoi se qëllimi i tij i vetëm i ardhjes në Kosovë në disa raste ka qenë blerja e një sasive të madhe cigaresh në mënyrë që të mund t'i shiste ato në Bullgari ngase gjatë vizitës së tij të parë këtu kishte vërejtur se këto ishin shumë më lirë në Kosovë. Dëshmoi se e njihte të pandehurin Martin Ivanov prej më së paku 15 vite, ngase jetonin në ndërtesën e njëjtë dhe janë miq. Para se të largoheshin nga Bullgaria, një person me emrin Petar i dha një çante të zezë kompjuteri me një laptop, një mbushës për bateri, me 3 kablllo rezervë, një çantë me modem 3G, 2 mbajtës plastikë, me kamera të vendosura brenda dhe pajisje elektronike, një USB dhe një qese të vogël plastike me pjesë rezervë elektronike. Kjo çantë është dashur t'i jepej një personi para Grand Hotelit në Prishtinë. Për të bërë një gjë të tillë, Plameni është dashur të thërrasë Petar dhe të përshkruajë se çfarë ka veshur; pastaj Petar do të kontaktonte personin në Prishtinë dhe do t'i tregonte atij pamjen e jashtme e personit që do të merrte çantën. Dorëzimi nuk ndodhi për shkak se të pandehurit u arrestuan para kësaj. Para kalimit të kufirit bullgar, kishte ekzaminuar çantën e zezë dhe gjetur mini kamerat për të cilat kishin menduar fillimisht se janë mjete shpërthyes, pasi që thirrën Petarin, ata u siguruan se pajisjet ishin kamera vëzhgimi për një mik që kishte një kafene në Prishtinë dhe dëshironte të mbikqyrte stafin.

Gjatë marrjes në pyetje, i pandehuri Martin Ivanov dëshmoi se njuh Plamen Dimitrov që një kohë të gjatë dhe se janë miq. Ishte ideja e Plamenit që të vinin në Kosovë për të blerë cigare ngase ky kishte qenë më parë në Kosovë dhe kishte zbuluar se cigaret ishin shumë më volitshëm në Kosovë. Dëshmia lidhur me vizitat në Kosovë ishte identike me atë të dhënë nga Plamen. Mirëpo, Martin Ivanov deklaroi se nuk e njuh Petar dhe se çanta e zezë ishte puna e Plamenit dhe se nuk kishte interesim për këtë gjë.

Deklaratat e dëshmtarëve (viktimave dhe zyrtarëve të policisë) asnjëherë nuk janë kontestuar nga palët. Ato reflektojnë aspekte të ndryshme të ngjarjeve të përshkuara në aktakuzë. Sigurisht se viktimat u përqëndruan vetëm në tërheqjen e e të hollave nga llogaritë e tyre bankare dhe modaliteti nga i cili kuptuan një gjë të tillë. Në anën tjetër, zyrtarët e policisë sqaruan se si ishte bërë hetimi dhe hapat procedural që janë ndërmarrë nga policia dhe prokurori.

Deklaratat e dëshmtarëve janë të besueshëm dhe nuk janë për t'u kontestuar shumë. Ato janë të plota dhe të detalizuara. Për më tepër, këto janë konfirmuar në mënyrë integrale në dosje.



E njëjta gjë nuk mund të thihet lidhur me deklaratat e dhëna nga të pandehurit gjatë marrjes së tyre në pyetje.

Arsyeja për të cilën të pandehurit kishin ardhur në Kosovë, për të blerë cigare me shumicë, arsyeja e vetme e vizitës së tyre, është thjesht jo e besueshme.

Të paktën pas dy vizitave të tyre ata u kthyen në Bullgari pa blerë asgjë. Ata kishin ndërmarrë një udhëtim të gjatë me dy makina (gjatë një rasti) dhe janë kthyer duarbosh pa blerë as sasinë e ligjshme, të paktën për të lehtësuar shpenzimet e bëra. Ata nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të krijuar kontakt për biznesin e tyre, dhe për këtë janë justifikuar duke thënë se cigaret janë aq lirë në Kosovë sa që ata kishin menduar të blinin me shumicën nga shitësit në rrugë. Ky nuk është spjegim i besueshëm për dy tregtarë të cilët donin të kishin fitim nga ky aktivitet.

Si përfundim arsyet e paraqitura nga të pandehurit nuk përputhen, nuk vërtetohen dhe nuk pajtohen. Ata nuk mund të konsiderohen nga Gjykata si bazë logjike për vendimin.

Të gjeturat ligjore

Gjykimi i dy të akuzuarve filloi në me një pikë të akuzës e cila u ndryshua.

Në fillim, Prokurori akuzoi dy të pandehurit për hyrje në sistemet kompjuterike të një banke dhe për tërheqje të parave në dëm të më shumë se tridhjetë personave por në fund të gjykimit Prokurori ndryshoi akuzën në hyrje e ngelur në tentativë.

Kjo ndodhi për shkak se Prokurori kuptoi, gjatë zhvillimit të gjykimit, se faktet ishin pjesërisht ndryshe nga ata që kolegu i tij kishte përshkruar në aktakuzë dhe se akuza fillestare nuk kishte mundësi reale për t'u konfirmuar.

Me fjalë të tjera, Z. Haki Gecaj ishte i mendimit se elementët e ofruar nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe nga dokumentet e dosjes (raportet e policisë, aktivitetet e policisë shkencore, kompjuteri dhe aparate të tjerë elektronike të cilat janë konfiskuar dhe analizuar, kërkuesat dhe raportet nga palët e dëmtuar) kanë treguar një rindërtim tjetër të faktit me atë që ishte shtruar fillimisht.

Z. Haki Gecaj kishte të drejtë.

Dëshmitë e Haxhi Arifit, Skender Misimit, Naser Sahitit dhe Sevdije Canollit vërtet konfirmuan se palët e dëmtuara (mes të cilëve dëshmitarët e sapo përmendur) vuajtën sulmin kundër llogarive bankare respektive gjë e cila rezultoi në humbje ekonomike të shumave të ndryshme përmes tërheqjeve të palejuara të cilat ndodhën rreth mesit të muajit shtator 2009 nga lokacione të ndryshme në Bullgari dhe Kanada.



Të akuzuarit u gjetën vërtet në posedim të instrumenteve të cilat padyshim çojnë në përfundimin e një përdorimi ekskluziv për hyrje të paligjshme në sistemin elektronik të një banke.

Por dëshmitë e dhëna në Gjykatë (dhe elementë të tjerë të mbledhura nga Prokurorja Publike hetuese, Znj.) nuk ishin të mjaftueshme për të përcaktuar se tërheqjet e listuara në aktakuzë ishin bërë nga të akuzuarit apo nga dikush tjetër i lidhur me ta, duke vepruar në bazë të të dhënave të mbledhura nga dy të akuzuarit. Në një mënyrë, mund të thuhet se Prokurori i cili hetoi fillimisht lëndën aplikoi parimin e *post hoc, ergo propter hoc* (latinisht "pas kësaj, prandaj për shkak të kësaj"). Apo, thënë në një gjuhë më prozaike, faktin se ajo ka arritur në përfundimin se për arsye se dy të akuzuarit u arrestuan menjëherë pas zbatimit të tërheqjeve të palejueshme dhe, për më tepër, të akuzuarit ishin nga Bullgaria (Shteti i cili qartësisht ishte i lidhur me disa prej tërheqjeve të palejueshme të cilat ishin kryer nga Bullgaria) atëherë duhet të kishte një lidhje shkakore, lidhje e cila ishte e mjaftueshme për të vërtetuar përgjegjësinë penale të dy të akuzuarve.

Është e vërtetë se Prokurori u përpoq që të analizonte kompjuterin i cili ishte konfiskuar nga të akuzuarit nga policia forensike në Kosovë (dëshmia e oficerit të policisë Avdush Jashari) si dhe jashtë Kosovës (Zijadin Isakut). Por, për shkak të pamundësisë për të analizuar gjithë informatat e ruajtura në kompjuter dhe duke konsideruar refuzimin e të akuzuarit për të bashkëpunuar, nuk është e qartë se si ishte e mundur që të vërtetohej se tërheqjet e listuara në aktakuzën fillestare ishin bërë nga dy të akuzuarit dhe jo, për shembull, nga kriminelë të tjerë që vepronin në Kosovë rreth së njëjtës kohë.

Në dosje nuk ka asnjë indikatë të procesit mendor i ndjekur nga Prokurori, i cili ka barrën jo vetëm të tregojë se është kryer një krim, por gjithashtu të indikojë elementin ku mbështetet përgjegjësia e të akuzuarit.

Një spjegim i mundshëm i iniciativës së Prokurorit kundër të akuzuarve, pasi u zbuluan dhe u arrestuan me mjetet elektronike për riprodhimin e kartelave, mund të gjendet në fjalët e Zijadin Isakut. Atij i kujtohej se në kohën e ngjarjeve (në mes të shtatorit 2009), kishte filluar lansimi i shumë sulme kundër sistemeve elektronike të bankave të ndryshme në Kosovë. Megjithatë, pas raportimeve të para, shumica e institucioneve kreditore, ndoshta të shqetësuara për përhapjen e lajmit mes klientëve të tyre mbi cënueshmërinë e sistemeve të tyre elektronike, hoqën dorë nga ngritja e padisë për të ndjekur penalisht autorin (ët) e sulmeve të tilla kundër tyre. Vetëm Banka Pro Credit këmbënguli dhe e çoi atë në Gjykatë, duke i dhënë Prokurorit mundësinë praktike që të ndjkë penalisht dy të akuzuarit (Neni 264.3 KKP parasheh se 'ndjekja penale për veprën penale nga ky nen fillohet sipas propozimit'). Në pritje të rezultatit të analizës së kompjuterit (i cili, nëse pozitiv, do të kishte konfirmuar akuzën) dhe duke marrë parasysh kufizimet e imponuara tek ajo nga vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës mbi paraburgimin (me ri-kualifikimin e veprës penale dhe nevojën për të ndjekur penalisht në bazë të aktakuzës), Prokurori nuk kishte zgjidhje tjetër përveç fillimit të



gjykimit, pa pasur sigurinë se kompjuteri përmbante informata të mjaftueshme për të vërtetuar se tërheqjet e palejueshme të regjistruara pak ditë para arrestimit të të dy akuzuarve mund t'u referohej atyre.

Sidoqoftë, zhvillimi i gjykimit ka zbuluar se shkelja e dyshuar fillestare nuk mund të vërtetohet për arsyet e paraqitura. Për këtë arsye, gjatë seancës së 14 prillit, Prokurori, në pajtim me Nenin 376 KPPK, e ndryshoi aktakuzën me qëllim që të reflektonte kryerjen e veprës penale të ngelur në tentativë, duke supozuar se konfiskimi i mjeteve elektronike nga të akuzuarit në mbrëmje të 18 shtatorit 2009 ishte i mjaftueshëm për të vërtetuar përgjegjësinë e tyre penale të paktën për tentativë për të kryer veprën penale të hyrjes në sistemet kompjuterike.

Siç u tha më lart, Prokurori kishte të drejtë.


Të akuzuarit (në veçanti, Martin Ivanov) kur u kap nga policia më datë 18 shtator 2010 në afërsi të bankomatit të Bankës Pro Credit, ishte në posedim të një prej dy mini kamerave të modifikuara.

Duhet të kuptojmë se të ashtuquajturat mini kamerat janë pjesë e një aparati kompleks dhe të sofistikuar, një aparatus i vendosur në një gjësend plastik së bashku me memorje dhe bateri. Kamera fshihet në bankomat dhe është në gjendje të regjistrojë imazhe të cilat ruhen për një kohë të gjatë dhe të cilat pastaj përdoren për krijimin e kloneve të kartave origjinale.

Spjegimet e dhëna nga të pandehurit për posedimin e këtij aparati (dhe të aparateve të tjera të gjetura dhe sekuestruara në vendin ku rrinin të pandehurit, në një hotelë në qytetin e Prishtinës) ishin thjesht qesharake. Ata treguan një histori të paqëndrueshme mbi një kërkesë të bërë nga dikush me emrin Petar (mbiemri i panjohur, e panevojshme të thuhet ...) dhe t'i çonin këto tek një person i cili do t'i kontaktonte më vonë dhe të cilin duhet t'a kishin takuar para Hotel Grandit në Prishtinë.

Si u tha më parë, nuk nevojitet shumë që kjo histori të hidhet poshtë. Është e mjaftueshme të thuhet se kjo i ngjan, në tërësinë e saj, historitë që dëgjoen gjithandej në botë, nga gjykatësit e çdo Vendi nga të pandehurit të cilët nuk kanë justifikim më të mirë. I njëjti gjykatës ka dëgjuar mbrojtje analoge të pabesueshme nga të pandehur në Itali, Portugali, Timorin Lindor, Britani, dhe kurdo ka pasur mundësi të ushtrojë funksionet e tij zyrtare apo studiojë për drejtësi në ato vende.

Si ka mundësi që dikush rastësisht vozit nga Bullgaria në Kosovë (vetëm për një udhëtim me të fejuarën apo për të kontrabanduar cigare) dhe pastaj ai pranon të transportojë aparate elektronike të dyshimta? Si ka mundësi që Plamen dhe Martin kanë pranuar t'i dorëzojnë gjëra të dyshimta në Kosovë dikujt të cilin ata nuk e njihnin vetëm në bazë të një kërkesë të thjeshtë të dikujt të njohur me emrin Petar? Është ofenduese për inteligjencën e gjykatësit dhe njerëzve të zakonshëm fakti se të pandehurit përpiqen të t'i shesin versione absurde një gjykatësi me përvojë.



Mungesa e provave mbështetëse, rrethanat e arrestimit (në afërsi të një bankomati me sjellje të dyshimtë – shih raportin e policisë), pretendimet e përgjithshme të pranisë së të pandehurve në Kosovë me qëllim që të kontrabandojnë cigare në Bullgari – një rrezik i tillë për disa euro!) bëjnë që justifikimet e të pandehurve gjatë marrjes së tyre në pyetje të jenë të pabesueshme.

Pra, cila ishte arsyeja për posedimin e kamerave dhe një kompjuteri me një softver për riprodhimin e kartelave të kreditit?

Përgjigja është e qartë.

Të pandehurit po përpiqeshin të vendosnin aparatin me qëllim që të hynin në sistemin kompjuterik të bankës.

Nuk është e mundur të deklarohet më tepër. Duke pasur parasysh sjelljen e të pandehurve në gjykatë, (të cilët paraqiten një version të pabesueshëm), hetimi filloi me arrestimin e të pandehurve dhe konfiskimin e mallrave të dyshimtë dhe në praktikë, ka përfunduar me këtë.

A është kjo e mjaftueshme për të vërtetuar përgjegjësinë penale të pandehurve? A mjafton vetëm posedimi i mallrave të dyshimtë në veçanti për qëllime të palejueshme për përbërjen e tentativës?

Gjykata mendon se po. Dispozita ligjore e Nenit 20, KPK parasheh se mund të përfshihet si tentativë çdo 'veprim i drejtpërdrejtë për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar'.

Vozitja nga Bullgaria në Kosovë me aparate të sofistikuara me qëllimin e kryerjes së një vepre penale përbën veprimin e paraparë me Nenin 20, KPK. Veprimi kërkonte një nivel diskret të një trajnimi teknik, aftësinë për të gjetur lokacionin e duhur dhe koordinimin e duhur me bashkë-kryerës të tjerë jashtë. E gjithë kjo tregon se aktiviteti penal i organizuar nga të pandehurit ishte i një natyre komplekse, pra mund të arrihet në përfundimin se kur të pandehurit u gjetën në Prishtinë, në Rrugën Bill Clinton, plani që kishin sajuar apo kontribuar për të sajuar ishte tashmë në fazën e zbatimit. Në këtë kuptim, nuk ishte një ide e përgjithshme, diçka që akoma duhej të zhvillohej, por ishte një plan i vënë tashmë në praktikë. Me fjalë të tjera, veprimi i tyre ishte pararendës i menjëhershëm i krimit (siç parashihet me nenin 20, KPK), ishte një hap i rëndësishëm për kryerjen e shkeljes penale. Sigurisht se ishte e qëllimshme, meqenëse orkestrimi i një krimi të tillë kompleks nuk mund të bëhet rastësisht.

Dënimi maksimal për shkeljen e Nenit 264, KPK është burgim deri në pesë vjet, e cila është mbi kufirin e paraparë me Nenin 20, KPK për tentativën e ndëshkueshme (me të paktën tre vjetë). Për këtë arsye, tentativa është e pranueshme.



Në këtë rast, për tentativë të kryerjes së veprës penale të hyrjes në sistemin kompjuterik mund t'i referohemi Nenit 264.1, 20 dhe 23, KPK.

Duke marrë parasysh rregullin e zbutjes së dënimit të paraparë me Nenin 20, paragrafi 3, KPK, dënimi përcaktohet në masën e një vit dhe gjashtë muaj burgim.

Të dy të pandehurit meritojnë të njëjtin dënim meqenëse nuk është e mundur të bëhet dallimi i përgjegjësisë së tyre penale. Ata kanë vepruar së bashku dhe kanë mbështetur njëri-tjetrin në mënyrë reciproke; kur u zbuluan, ata koordinuan një version të pavërtetë, duke refuzuar kështu që të spjegojnë kontekstin e vërtetë të aktivitetit të tyre kriminal.

Masa e dënimit është proporcionale me dënim të cilët të pandehurit kishin për qëllim t'u shkaktonin viktimave. Fakti se ata vinin nga jashtë për të hyrë në llogaritë bankare të personave të tjerë bën të thjeshtë të besohet se ata nuk kishin për qëllim të kufizonin veten duke tërhequr të holla nga një apo pak klientë të bankës, por ata do të kishin nxjerrë pin kodet dhe të dhënat e kartelave të kreditit për një kohë para se të fillonin me riprodhimin e kartelave të kreditit, pra shkaktimin e një dëmi të madh (dhe një avantazh të palejuar si shkak i kësaj për veten e tyre).

Një vit e gjysëm është mjaftueshëm për larguar të pandehurit dhe ndihmësit eventuale nga kryerja e një aktiviteti kriminal të mëtejshëm. Për më tepër, moshë relativisht e re e të pandehurve është në favor të tyre në përcaktimin e dënimit.

Koha e kaluar në paraburgim nga 18 shtator 2009 derisa aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm do të llogaritet si pjesë e dënimit me burgim në pajtim me Nenin 73, KPK.

Në pajtim me Nenin 54, paragrafi 2, pika 9, KPK, dy të akuzuarit do të dëbohen nga territori i Kosovës pas vuajtjes së dënimit në bazë të kërkesës së prokurorit.

Dy të pandehurit nuk mund të lihen të lirë menjëherë: mundësia që vendimi të zbatohet është i lidhur me burgimin e tyre. Në rast se ata lihen të lirë, ata sigurisht se do të largoheshin nga Kosova dhe do të kërkonin strehim në Bullgari nga ku do të duhej të fillohej procedura e ekstradimit.

Pika e fundit ka të bëjë me palën e dëmtuar.

Dëmet e shkaktuara Pro Credit Bankës është shënuar në shumën prej 13, 557. 55 Euro. Banka ka listuar rreth 32 palë të dëmtuara, të cilët janë kompensuar për humbjet e pësuar.

Megjithatë, gjatë zhvillimit të gjyqimit, pika e akuzës u ndryshua duke u shndërruar nga kryerje e hyrjes në tentim hyrjeje.



Sigurisht se nëse përmendet një tentim hyrjeje, kjo do të thotë se hyrja nuk ka ndodhur akoma. Si pasojë, akoma nuk ka pasur dëm.

Pro Credit Banka ka kompensuar dëmet që pësuan klientët e saj. Kjo nuk kundërshtohet. Megjithatë, në këtë gjykim nuk ka prova se dëmi është shkaktuar nga dy të pandehurit.

Për këtë arsye, kërkesa e përfaqësuesit të institucionit kreditor refuzohet.

KONFISKIMI

Në pajtim me Nenin 60, KPK dhe 489, KPPK, kompjuteri (laptop), konfiskohen mini kamerat dhe shuma prej 3.055,00 euro. Aparatet elektronike do të shkatërrohen pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm. Të hollat do t'i jepen Buxhetit të Kosovës pasi vendimi është bërë i plotfuqishëm.

SHPENZIMET

Në pajtim me Nenin 102, paragrafi 1, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) personat e dënuar paguajnë shpenzimet e procedurës në shumën e dyqind (200) Euro.

Proces-mbajtëse

Gjykatësi nga EULEX

Jacqueline Ryan

Francesco Florit

KËSHILLË JURIDIKE:

Në pajtim me Nenin 473, paragrafi 3, **Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)**, kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë brenda tetë ditëve nga dorëzimi i aktgjykimit me shkrim.

